



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.985/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Lumni Sallauka e Hunaida Pasuli anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit Q.B. nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria për Arsim, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Diellon Gjonbalaj, objekti i kontestit, kompensim i pagave pas pensionimit, vlera e kontestit 2,137.50€, duke vendosur sipas ankesës të palës së paditur e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1149/19 i datës 23.09.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.09.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesërishëm të ankesës së palës së paditur Komuna e Prishtinës, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1149/19 i datës 23.09.2019 dhe gjykohet: DETYROHET e paditura që paditësit për shpërblimin jubilar, t'ia paguaj shumën prej 534.37€, pjesa e kërkesëpadisë për shpërblimin jubilar mbi këtë shumë REFUZHET, ndërsa sa i përket pjesës tjetër të dispozitivit ankesa e të paditurës REFUZHET si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar me ankesë në këtë pjesë VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Q.B. nga fshati ..., Komuna e Prishtinës, detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria për Arsim që paditësit në emër të 3 pagave përcjellëse dhe 3 pagave jubilarë në pension, t'ia paguaj paditësit për secilën pagë neto, shumën prej 356.25€ apo në shumën e përgjithshme në lartësi prej 2,137.50€, me kamatë vjetore në lartësi prej 8% duke filluar nga data 16.04.2019, dita e ushtrimit të kërkesëpadisë, në gjykatë dhe shpenzimet procedurale në shumën prej 20.00€, krejt këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, si gjykatë e shkallës së dytë këtë ankesë ta aprovjë dhe aktgjykimin e ankimuar ta

prishë dhe ta kthejë çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë ose ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi në padi ka kërkuar që të detyrohet e paditura që t'ia paguaj në emër të tri pagave përcjellje pas pensionimit dhe tri paga për shpërblim jubilar në vlerë të përgjithshme prej 2,137.50€, në lartësi të pagës mujore në shumë prej 356.25€ duke theksuar bazën në Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitar Nr.01B-2056 e datës 18.04.2017 sipas dispozitës së nenit 35.8 dhe 35.9 të po të njëjtës kontratë, me propozim që gjykata ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi për pensionimin e punëtorit me nr.14 nr.118/02-02958DD/18 i datës 18.12.2018, vërtetimi i datës 15.04.2019 dhe transaksionet bankare të datës 31.12.2018.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar këtë gjendje faktike se: nuk është kontestuese se paditësi ka qenë punëtor me detyrat e mësimdhënies i lëndëve gjuhë dhe letërsi shqipe, në shkollën SHMU- "Ali Kelmendi" në Prishtinë. Përvoja e punës së paditësit tek e paditura është nga data 01.09.1974 deri me datë 14.12.2018, e që i bie mbi 44 vite përvojë pune. Baza e kërkesëpadisë po ashtu edhe lartësia e saj nuk janë kontestuese.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: "Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 , pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji".

Neni 195.1 i LPK-së: "Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) të refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe të vërtetojë aktgjykimin e goditur".

Neni 195.1 i LPK-së: "Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj: e) të ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë.

Neni 319.1 i LPK-së: "Secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta".

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Nisur nga gjendja e vërtetuar faktike Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të të paditurës lidhur me atë se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nuk qëndrojnë pasi nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë dhënë arsye të plota dhe të kuptueshme për faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore. Kolegji vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk përmban shkelje esenciale nga dispozitat e nenit 182 par.2 të LPK-së për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension me datë 14.12.2018, dhe se i njëjti ka përvojë pune si mësimdhënës mbi 44 vite. Përveç kësaj nuk ka qenë kontestuese as lartësia e pagave.

Kolegji gjenë se, me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive".* Ndërsa me nenin 35 par. 8, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, përcaktohet se: *"I punësuarit, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 8.1) për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë 50% të një page bazë; 8.2) për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3) për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page bazë, dhe 8.4) për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë".* Me paragrafin 8.5 të të njëjtit nen përcaktohet se: *"Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuarit ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse".* Ndërsa, në pikën 9 të të njëjtit nen është parashikuar që: *"punëtorët që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi prej tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit".*

Sa i përket pjesës së vërtetuar të dispozitivit, kolegji gjenë se bazuar në përshkrimin dhe elaborimin ligjor dhe faktik të përshkruar si më sipër, në këtë pjesë edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë. Lidhur me këtë pjesë, kolegji pretendimet ankimore të të paditurës i ka refuzuar si të pa bazuara në kuptim të nenit 319.1 të LPK-së, në të cilin është përcaktuar se *secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.* Në këtë pjesë, kolegji gjenë se pala e paditur nuk ka arritur që të bëjë argumentimin e fakteve në procedurë dhe thëniet e të njëjtës kanë ngelur vetëm në nivelin e pretendimeve.

Lidhur me pretendimet ankimore në pjesën sa i përket shpërblimit jubilar, kolegji gjenë se, duke pasur parasysh se paditësi ka 44 vite përvojë të punës dhe për 40 vjet të përvojës së punës bazuar në nenin 35 par 8.4 të punësuarit i takon 150% e një page bazë", në rastin konkret paga

bazë e paditësit ka qenë 356.25, ndërsa 150% e pagës bazë është 534.37€. Në një gjendje të tillë të çështjes, kolegji gjenë se qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se në këtë pjesë aktgjykimi i atakuar me ankesë është përfshirë me zbatim të gabuar të të drejtës materiale. Prandaj, gjykata e shkallës së dytë duke u bazuar në nenin 195.1, pika e) të LPK-së, e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me tri paga jubilarë, duke ndryshuar në këtë pjesë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe duke miratuar shumën në lartësinë e theksuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) dhe e) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.985/2020, me datë 14.09.2020.

Kryetari i kolegjit-gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj, d.v